



PUNËSIMI

SI SFIDË E

RI-INTEGRIMIT

DHE RISOCIALIZIMIT

Përmbajtja

3 - HYRJE

4 - QASJA STRATEGJIKE E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS NDAJ RI-INTEGRIMIT TË RIKTHYERVE

6 - ROLI I SHËRBIMIT KORREKTUES PËR RI-INTEGRIMIT dhe RISOCIALIZIMIT TË RIKTHYERVE

8 - ROLI I SHËRBIMIT SPROVUES PËR RI-INTEGRIMIN E TË RIKTHYERVE

10 - ROLI I DIVIZIONIT TË MPB-SË PËR PARANDALIM DHE RI-INTEGRIMIN TË RIKTHYERVE

12 - ROLI I AGJENCISË SË PUNËSIMIT DHE QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE PËR RI-INTEGRIMIN E TË RIKTHYERVE

15 - REKOMANDIME

HYRJE;

Kosova është në mesin e vendeve më të varfëra në rajon. Varfëria dhe mungesa e perspektivës ekonomike vlerësohen të jenë në mesin e shtytëseve në radikalizmin e shoqërisë Kosovare. Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2023¹, dhe Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 - 2020² identifikon varfërinë si një ndër faktorët kyç të radikalizmit të shoqërisë Kosovare.

Të dhënat tregojnë që niveli i papunësisë dhe mungesa e perspektivës vazhdon të jetë problem për vendin, sidomos për kategori të caktuara shoqërore.

Papunësia paraqet një nga fushat më problematike të zhvillimit në Kosovë. Agjencia e Statistikave të Kosovës ka vlerësuar se në vitin 2020:

- “Dy të tretat e popullsisë kosovare janë në moshë pune”;
- “61,7% e tyre nuk janë ekonomikisht aktivë”;
- Nga “38,3% e pjesës ekonomikisht aktive, vetëm 12,4% janë të punësuar”;
- “Shkalla e papunësisë është më e lartë për vajzat/gratë sesa për burrat” (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2020).

Duke e pasur parasysh që mungesa e një vendi pune apo kushteve ekonomike janë faktorë kyç në radikalizëm, BIRN ka arritur të grumbulloj të dhëna statistikore, por edhe empirike të cilat tregojnë që problemet e varfërisë në zonat me rrezik të lartë vazhdojnë të jenë evidente dhe si rrjedhojë edhe të identifikohen si rrezik në shpërndarjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Mbi 400 kosovarë u përfshinë në një mënyrë apo tjetër në luftën në Siri dhe Irak, ndërsa dhjetëra të tjerë u vranë, apo vazhdojnë të jenë në burgje në zonat e luftës.

Në vitin 2019 Kosova riatdhesoi 32 gra dhe 74 fëmijë, proces i ngjashëm u zhvillua edhe në vitin 2021.³ Këta të rikthyer supozojnë se do kalonin në një proces rehabilitimi dhe ri-integrimi gjatë të cilit familjet e tyre do siguronin pavarësi ekonomike dhe qëndrueshmëri financiare për të rindërtuar jetën në Kosovë.

Edhe pse të dhënat mbahen jo publike hulumtimet në terren tregojnë që një pjesë e vogël e të rikthyerve kanë qëndrueshmëri financiare, pasi ende nuk kanë vende pune të sigurua apo të hyra nga bizneset.

A very important process is the process of reintegration of convicted persons. The data received from the Kosovo Correctional Service (KCS) show that over 60% of prisoners convicted of terrorism are not involved in any way in professional capacity training and development processes.

¹Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2023. <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/46/STRATEGJIA%20SHTET%C3%8BRORE%20KUND%C3%8BR%20TERRORIZMIT%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20E%20%93%202023.pdf>, faqe 4.

²Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 - 2020. https://kryeministri.rks-gov.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf, faqe 13.

³KALLXO.com. 'Harta' e ngjarjeve që përcollën 110 kosovarët e kthyer nga Siria. <https://kallxo.com/shkurt/harta-e-ngjarjeve-qe-percollen-110-kosovaret-e-kthyer-nga-siria/>

Ndaras kësaj të rikthyerit para vitit 2019-të nuk janë përfshirë në programe të punësimit. Jashtë këtij procesi u lanë edhe familjet e personave të vrarë në zonat e luftës.

Proces mjaft i rëndësishëm është procesi i ri-integrimit të personave të dënuar të dhënat e pranuar nga shërbimi korrektues i Kosovës tregojnë se mbi 60% e të burgosurve të dënuar për terrorizëm nuk janë përfshirë fare në procesin e trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të tyre.

Ky hulumtim paraqet të dhëna të cilat argumentojnë që me gjithë përpjekjen, krijimi i një klime të përshtatshme ekonomike ende është faktor që mund të ndikoj në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Për qëllim të realizimit të kësaj analize, janë grumbulluar të dhëna nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Agjencia e Punësimit të Kosovës në nivel qendror dhe lokal, janë kërkuar të dhëna nga zyrat lokale të punësimit dhe qendrat për punë sociale në këto komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan, Pejë, Prizren, Gjakovë, Drenas, Skenderaj, Kaçanik, Han i Elezit, Viti, Shtime dhe Istog, si dhe janë kërkuar të dhëna nga Divizioni për Parandalim dhe Ri-integrim në kuadër të Departamentit për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Aktivitetet e parapara nisin nga niveli qeveritar e deri tek institucionet lokale të cilat ndër vite është dashur të realizojnë aktivitete të cilat garantojnë punësimin dhe rritjen e mirëqenies ekonomike.

QASJA STRATEGJIKE E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS NDAJ RI-INTEGRIMIT TË RIKTHYERVE

Dokumenti i parë strategjik i Republikës së Kosovës që e trajton procesin e parandalimit, intervenimit, deradikalizimit dhe ri-integrimit ishte: Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020⁴

Ky dokument strategjik ndërinstytucional njërën nga katër objektivat kryesore strategjike e kishte të paraparë edhe deradikalizimin dhe ri-integrimin e personave të radikalizuar.

Po ashtu, kjo strategji kishte paraparë edhe veprimet dhe masat specifike me qëllim të realizimit të objektivës.

Megjithatë, edhe pse e shtjellon procesin e deradikalizimit dhe ri-integrimit, kjo Strategji i dedikohet personave të cilët rrezikojnë të përfshihen në veprime të ndaluara apo janë në fazat finale të radikalizimit përderisa problemin e personave që tashmë kanë rënë ndesh me ligj vetëm e referon tek 'ligjet e tjera', duke përmendur Ligjin për Ndalimin e Pjesëmarrjes në luftërat e huaja⁵.

Po ashtu, Strategjia Kundër Terrorizmit e cila është ende në fuqi me aktualitet kohor, në pjesën narrative nuk e trajton fare këtë pjesë tek objektivat strategjike – parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe reagimi nuk parashohin asgjë në drejtim të punësimit si mjet i ri-integrimit të personave që tashmë kanë shkelur ligjin, janë dënuar dhe pritet të kthehen të risocializuar në shoqëri.

⁴Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020. https://kryeministri.rks-gov.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

⁵KALLXO.com. 'Harta' e ngjarjeve që përcollën 110 kosovarët e kthyer nga Siria. <https://kallxo.com/shkurt/harta-e-ngjarjeve-qe-percollen-110-kosovaret-e-kthyer-nga-siria/>

⁶Drafti i Strategjisë Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit 2021 - 2026 që BIRN ka përdorur për qëllimin e kësaj analize.

Në këtë drejtim, Draft Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm 2021-2026 dhe plani i veprimit të Draft Strategjisë përbëjnë hapa para drejt trajtimit, aftësimit, punësimit dhe ri-integrimit të personave të dënuar për vepra penale që lidhen me terrorizmin.

Draft Strategjia Shtetërore Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm 2021-2026 dhe plani i veprimit 2021-2026 kanë paraparë po ashtu katër objektiva strategjike: a) Parandalimi; b) Mbrojtja; c) Ndjekja dhe d) Reagimi, ndërsa janë paraparë edhe qëllimet specifike ku tek pjesa – ‘Hartimi dhe zbatimi i planeve për rehabilitim dhe ri-integrim’ janë paraparë 22 aktivitete specifike me qëllim të realizimit të qëllimit specifik dhe objektivës strategjike⁶.

Në fillim të Janarit 2022, Ministria e Punëve të Brendshme nxori një vendim për krijimin e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, duke e dërguar në thelb projekt-strategjinë në pikën zero. Kjo është bërë me qëllim të hartimit të një strategjie të re deri në Tetor 2022, e cila do të bënte një shkrimje mes Strategjisë aktuale kundër Terrorizmit dhe Strategjisë për Parandalimin.

Në takimin e parë për strategjinë e re që u mbajt më 22 Janar, ku pjesë e saj ishin edhe përfaqësues të BIRN-it, u diskutua për planin e punës, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve, krahas përmbajtjes tematike të dokumentit të ri.

Vlerësuar nga përmbajtja e aktiviteteve specifike për realizimin e objektivës strategjike rezulton se të paktën 15 objektiva specifike synojnë rehabilitimin dhe ri-integrimin e të kthyerve dhe të dënuarve dhe familjarëve të tyre në forma të ndryshme duke përfshirë, trajnimet, aftësimet, grantet, pakot emergjente, por edhe në forcimin e kapaciteteve institucionale siç është mbështetja e Divizionit për Parandalim dhe Ri-integrim me staf shtesë.

Nga analizimi i aktiviteteve specifike rezulton se zbatimi i strategjisë vlerësuar edhe sipas Planit të Veprimit është i kushtëzuar nga donacionet. Pothuajse të gjitha aktivitetet specifike janë paraparë të financohen edhe nga donacionet, ndërsa pesë prej aktiviteteve konkrete është paraparë të financohen vetëm nga donacionet duke mos paraparë buxhet fare për to.

Përtej varësisë nga donacionet, Draft Strategjia duket se është tërësisht e orientuar kundrejt indikatorëve sasiorë, që jo domosdoshmërisht pasqyrojnë edhe realizimin e qëllimeve specifike dhe rrjedhimisht objektivave strategjike.

Po ashtu, lidhur me këtë qëllim specifik, aktivitetet specifike duken shumë të përgjithësuara, pa individualitet, dhe ndonjëherë abstrakte.

Përderisa pjesa narrative e Draft Strategjisë përcakton se Planin e Veprimit do të përmbajë ‘aktivitetet konkrete’, Dokumenti i Planit të Veprimit tek qëllimi specifik ‘Hartimi dhe zbatimi i planeve për rehabilitim dhe ri-integrim’ - shumë nga ‘aktivitetet konkrete’, vetëm përshkruhen si ‘aktivitete specifike’, pa i konkretizuar apo përshkruar aspak ato aktivitete, siç edhe do të duhej.

Si shembull, një nga aktivitetet konkrete të parapara në planin e veprimit - ‘mbështetje me pako emergjente të subjekteve’ - nuk është paraparë fare mënyra e financimit të këtij aktiviteti.

Në vazhdim të kësaj analize do të pasqyrohen roli, kompetencat, funksioni, veprimet e deritanishme, koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve në mes të disa institucioneve në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të personave të rikthyer dhe të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin.

ROLI I SHËRBIMIT KORREKTUES NË RI-INTEGRIMIN DHE RISOCIALIZIMIN E TË RIKTHYERVE

Analizimi i të dhënave tregon se programet e ri-integrimit dhe risocializimit në burgjet e Kosovës nuk arrijnë t'i përfshijnë të gjithë të burgosurit e dënuar për terrorizëm. Të dhënat tregojnë që më pak se 40% e të burgosurve të cilët tashmë janë liruar kanë kaluar në procese të aftësimit profesional. Të tjerët janë liruar nga burgjet pa marrë trajnime dhe pa zhvilluar aftësi të cilat do i bënin të aftë për tregun e punës.

Shërbimi Korrektues i Kosovës (Më tej referuar si SHKK), është Agjenci që vepron në Kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), SHKK është përgjegjës për organizimin mbikëqyrjen dhe zbatimin Sanksioneve Penale. Veprimtaria e tij është risocializimi i personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit dhe ri integrimi i tyre në shoqëri duke kryer kështu një detyrë me rëndësi në mbrojtjen e Republikës së Kosovës nga përsëritja e veprave penale dhe parandalimi i kriminalitetit në të ardhmen.⁷

Përveç organizimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së ekzekutimit të sanksioneve penale një nga detyra e SHKK-së është edhe organizimi i programeve që i kontribuojnë riedukimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjate të personave të dënuar.

Një nga synimet e SHKK-së është të kontribuojë në uljen e recidivizmit përmes programeve që i dedikohen rehabilitimit dhe ri-integrimit të burgosurve, e po ashtu ofrimi dhe mundësimi i qasjes për të burgosurit në programe të arsimimit dhe aftësimit profesional.

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka edhe Njësinë Ekonomike të Shërbimit Korrektues në kuadër të së cilës zhvillohen disa veprimtari, siç janë: Dega e perimtarisë; Dega e fushës së hapur; Dega e agro-punëtorisë; Dega e blegtorisë; dhe Dega për mirëmbajtje të ambientit.

Po ashtu, krahas mundësimit të arsimimit që zhvillohet brenda SHKK-së e që është i barasvlershëm me arsimimin që zhvillohet jashtë SHKK-së, në kuadër të SHKK-së zhvillohen edhe disa programe të aftësimit profesional si në vijim: Teknologji e informacionit (word-exel); Instalues të ujit dhe kanalizimit; Axxhustator; Saldues; Zdrukthëtar; dhe Ndërtimtari (Qeramikë, fasadues, armirues, muratorë, latues, etj.).

Po ashtu, një nga mundësitë që ka SHKK është që përmes marrëveshjes me subjektet ekonomike private, të angazhoj të burgosurit në punë jashtë SHKK-së.⁸

Të gjitha këto mundësi të parapara me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e SHKK-së, synojnë që të dënuarit, gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit të arsimohen, aftësohen, punësohen, e me këtë i kontribuohet risocializimit dhe ri-integrimit të plotë të tyre në shoqëri. Krejt kjo ndikon në reduktimin e përsëritjes së veprave penale.

⁷Shërbimi Korrektues i Kosovës- Historiku <https://shkk.rks-gov.net/shkk/480/historiku/480>

⁸Shërbimi Korrektues i Kosovës- Historiku <https://shkk.rks-gov.net/shkk/480/historiku/480>

Në kontekst të analizës, këto mundësi dhe synime të SHKK-së kanë vlerë dhe rëndësi edhe më të madhe.

Në të gjitha dokumentet strategjike shtetërore por edhe në raportet vendore dhe ndërkombëtare, evidentohen si faktorë shtytës dhe nxitës për përfshirjen e shtetasve Kosovë në luftërat e Sirisë dhe Irakut, faktorët psiko-social.⁹

Gjendja e keqe ekonomike, mungesa e perspektivës së punësimit, niveli jo i duhur arsimor, mundësitë e pabarabartë ekonomike, evidentohen si ndër faktorët më të rëndësishëm që i kontribuuan pjesëmarrjes së të rinjve nga Kosova në radhët e grupeve terroriste.

Kështu, krahas rëndësisë që ka SHKK në parandalimin e radikalizmit të burgosurve tjerë nga të dënuarit për vepra që lidhen me terrorizëm, jetike vlerësohet edhe arsimimi, aftësimi dhe përgatitja profesionale e të dënuarve për jetën pas lirimit nga burgju.

Roli dhe rëndësia e SHKK-së pasqyrohet edhe në Planin e Veprimit të Draft Strategjisë.

Gjashtë nga tetë aktivitetet konkrete të parapara me Planin e Veprimit, në të cilat obligohet SHKK, kanë të bëjnë me rehabilitimin dhe ri-integrimin.

BIRN ka dërguar kërkesë për qasje në dokumente/informacion në SHKK dhe ka pranuar të dhëna lidhur me punët e deritanishme të SHKK-së në drejtim të dënuarve për përfshirje në vepra që ndërlidhen me terrorizmin.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme pasqyrojnë numrin e të dënuarve që janë liruar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës nga viti 2018, deri në dhjetor të vitit 2021

Numri i të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin të liruar nga SHKK përgjatë viteve 2018 – 2021	
2018	14 të dënuar
2019	14 të dënuar
2020	19 të dënuar
2021 (deri dhjetor)	9 të dënuar
Gjithsej të dënuar të liruar	56 të dënuar
Në vuajtje të dënimit aktualisht në SHKK	16 të dënuar

Po ashtu, nga të dhënat e siguruara nga SHKK rezulton se disa prej të dënuarve kanë mbajtur trajnime të ndryshme profesionale gjatë vuajtjes së dënimit.

Tabela në vijim tregon numrin e personave të aftësuar profesionalisht në zdrukthëtarë, saldim, instalim të ujit, gjatë vuajtjes së dënimit në raport me numrin e përgjithshëm të personave që ishin dhe janë në vuajtje dhe të cilët nuk kanë ndjekur ndonjë aftësim profesional.

⁹Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020. https://kryeministri.rks-gov.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

Persona të aftësuar gjatë vuajtjes së dënimit	28 persona
Persona të paaftësuar gjatë vuajtjes së dënimit	44

Nga të dhënat e siguruar nga SHKK rezultojnë se 78% e të dënuarve për terrorizëm që ishin në vuajtje së paku nga viti 2018 – 2021 janë liruar nga vuajtja e dënimit ndërsa mbi 61% e të dënuarve (atyre të liruar dhe atyre që aktualisht janë në vuajtje), nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim apo aftësim profesional gjatë vuajtjes së dënimit të tyre.

Kjo tregon se këta persona nuk kanë marrë ndonjë profesion tjetër apo ndonjë avancim i cili do i orientonte në karrierë pas daljes nga burgu.

Të dhënat e grumbulluara tregojnë se ndër sfidat kryesore pse të dënuarit nuk i ndjekin programet grumbullohen në kohën e shkurtër të dënimeve dhe mungesën e programeve atraktive.

Një pjesë e personave të dënuar në Kosovë e kanë kaluar pjesën më të madhe të dënimit në paraburgim. Gjatë qëndrimit në paraburgim personat nuk përfshihen në programe rehabilitimi dhe si rrjedhojë nuk mund të ndjekin kurse dhe trajnimet të cilat ofrohen brenda burgjeve.

Të dhënat nga Shërbimi Korrektues tregojnë që një pjesë e madhe e programeve të trajnimeve dhe aftësimit profesional brenda burgjeve është e orientuar në ndërtimtari dhe bujqësi. Programe të tilla llogariten si të pafavorshme për një pjesë të madhe të të rikthyerve, pasi mbi 50% janë nga zonat urbane ku nuk zhvillohet bujqësia dhe nuk ka prirje për t'u marrë me punë të ndërtimtarisë.

ROLI I SHËRBIMIT SPROVUES PËR RI INTEGRIMIN E TË RIKTHYERVE

Pjesa më e madhe e grave të cilat janë rikthyer nga zonat e luftës janë të dënuara me kusht nga gjykatat e Kosovës. Lirimi me kusht do duhej t'i nënshtrohej një procesi serioz dhe me shumë kritere të cilat masin aktivitetin e të liruarit gjatë qëndrimit në liri.

Shërbimi Sprovues i Kosovës (tutje referuar si SHSK), sikurse SHKK është Agjenci në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. ShSK në Planin e Veprimit të Draft Strategjisë përmendet vetëm rreth dy aktiviteteve konkrete që përcakton Draft Strategjia.

ShSK obligohet lidhur me veprime specifike që rreth të burgosurve në fazën e pas liritit por edhe në koordinimin dhe fuqizimin ndërsektorial në luftimin e terrorizmit dhe veprave që ndërlidhen me terrorizmin.

Në kuadër të mandatit të vet SHSK ka kompetenca shumë të rëndësishme, ndër to:

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të ri-integrimit shoqëror të personave të dënuar (punët sprovuese);
- Përgatitjen e anketës sociale dhe raportet parandëshkuese për kryerësit e veprave penale;
- Vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale;
- Mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative;
- Mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar të liruar me kusht;
- Zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes;
- Hartimin e raporteve për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe personave të liruar me kusht nga burgu për Prokurorit, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- Mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative në sistemin elektronik për menaxhimin e të dhënave;

Siç evidentohet nga përgjegjësitë e ShSK-së, rëndësia këtij institucioni, sa i përket mbikëqyrjes, zhvillimit të programeve individuale të mbikëqyrjes, udhëzimin dhe mbështetjen e të dënuarve por edhe evidencimin e regjistrave dhe masave të dënimeve alternative, ShSK ka rol vendimtar në rehabilitimin, risocializimin dhe ri-integrimin e të dënuarve.

Në kontekst të kësaj analize, Draft Strategjia dhe Plani i Veprimit nuk e angazhojnë ShSK-në që t'i ushtojë përgjegjësitë e saj në raport me të dënuarit për terrorizëm.

Sigurisht se, ShSK mandatin e saj e ushtron në përputhje me legjislacion aktual për secilin të dënuar mirëpo, Draft Strategjia si dokument shtetëror ndërsektorial duhet të pasqyrojë rolin dhe rëndësinë e ShSK-së në ri-integrimin dhe risocializimin e të dënuarve për vepra penale të terrorizmit, në veçanti duke pasur parasysh seriozitetin, kompleksitetin dhe rrezikshmërinë e të dënuarve për vepra penale të terrorizmit dhe dukurisë së terrorizmit – qoftë në rrafshin e brendshëm por edhe në atë global.

Për qëllim të kësaj analize BIRN ka kërkuar informacion edhe nga ShSK për angazhimin e këtij institucioni rreth aftësisimit profesional, punësimit e vetëpunësimit të personave të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin .

¹⁰Kosovo Probation Service. History. Available at: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,19>

¹¹For the purposes of conducting this analysis, BIRN submitted officials requests for access to documents and information as well as direct interviews with Employment Offices and Social Centers in ten municipalities, with the Ministry of Internal Affairs, Employment Agency, Department for Public Safety at Kosovo Police, Ministry of Justice – Correctional Services and Probation Services.

Megjithëse nga ky institucion potencohet se në bashkëpunim Divizionin e Punëve Ministrisë së Punëve të Brendshme për parandalim dhe ri-integrim kanë ofruar mbështetje për disa persona evidentohen vështirësitë financiare dhe gjendja e përgjithshme socio ekonomike në vend “Natyrisht që duhet të kemi parasysh gjendjen ekonomiko sociale dhe mungesën e vendeve të punës në përgjithësi në Kosovë” , tha për BIRN, Metije Ademi zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues.

Ademi më tej thekson se Shërbimi Sprovues i Kosovës nuk ka një program të veçantë aftësimi, punësimit apo vetëpunësimit për kryerësit e dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin.

Nga ShSK thuhet se evidentimi i nevojave të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin bëhet gjatë hartimit të planeve individuale të punës dhe përmes partnerëve shikohet mundësia e gjetjes së ndonjë angazhimi.

Po ashtu, nga të dhënat e SHSK evidentohet se 15 persona – kryesisht gra janë aftësuar në bashkëpunim me Divizionin e MPB-së, ndërsa pjesa tjetër e të dënuarve edhe pse kanë shprehur gatishmëri nuk kanë mundur për shkak të përkujdesjes ndaj fëmijëve dhe obligimeve tjera familjare.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme tregojnë numrin e të punësuarve/vetë punësuarve në raport me numrin e të liruarve me kusht.

Numri i të liruarve me kusht dhe numri i të punësuarve sipas ShSK-së

32 të liruar me kusht

15 të punësuar dhe vetëpunësuar

Nga të dhënat e Shërbimit Sprovues të Kosovës vlerësohet bashkëpunimi me Shërbimin Korrektues, Divizionin e MPB-së, Zyrat rajonale të Agjencisë së Punësimit ndërsa potencohet nevoja për staf dhe trajnime shtesë.

“Sfida kryesore e Shërbimit Sprovues, janë programet rehabilituese dhe numri i kufizuar i zyrtareve sprovues për t`u marr me këtë kategori. Mandej çështjet e punësimit dhe angazhimi i tyre në aktivitete tjera të cilat do të ndihmonin në integrimin e tyre më të lehtë në shoqëri. Nevoja për trajnime të specializuara për stafin SHSK është më së e domosdoshme. Kjo është edhe për faktin se veprat e kësaj natyre kërkojnë qasje shumë profesionale dhe shkathtësi për të ofruar ndihmë dhe mbështetje në largimin e tyre nga këto vepra dhe risocializimin e plotë të tyre në shoqëri”, tha Metije Ademi për BIRN.¹³

ROLI I DIVIZIONIT TË MPB-SË PËR PARANDALIM DHE RI-INTEGRIMIN TË RIKTHYERVE

Divizioni për Parandalim dhe Ri-integrim të Personave të Radikalizuar (në tekst referuar si Divizioni) është krijuar për të koordinuar, bashkëpunuar, komunikuar, monitoruar, vlerësuar procesin e ri-integrimit. Divizioni operon nën ombrellën e Departamentit për Siguri Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme.¹⁴

Roli i këtij institucioni është udhëheqës në procesin e ri-integrimit vendimtar në luftën ndaj dukurisë së terrorizmit në përgjegjësi.

BIRN ka grumbulluar të dhëna nga ky institucion me qëllim të realizimit të kësaj analize.

¹²Intervista dhe përgjigje përmes e-mailit për BIRN datë 7 dhjetor 2021

¹³Intervista dhe përgjigje përmes e-mailit për BIRN datë 7 dhjetor 2021

¹⁴Ministria e Punëve të Brendshme. Divizioni për Parandalim dhe Riintegrim të Personave të Radikalizuar. <https://mpb.rks-gov.net/f/78/Divizioni-per-Parandalim-dhe-Riintegrim-te-Personave-te-Radikalizuar>

Nga të dhënat rezulton se Divizioni ka vetëm një program “një program R&R për këtë kategori dhe plane individuale për punësim dhe vetëpunësim. Programi R&R si njërin nga elementet e intervenimit ka edhe përmes programit të mentorimit, i cili akoma është draft dhe do të ndihmonte familjet në punësim dhe vetëpunësim”,

Të dhënat e siguruar nga Divizioni rezulton se janë vetëpunësuar 23 persona që ishin në vuajtje të dënimit, ndërsa 6 persona janë në procedurë të përfitimit të grantit bazuar në aftësitë e fituara nga programi R&R. Po ashtu, sipas të dhënave, Divizioni ka ofruar trajnime profesionale për 3 persona për menaxhim të financave pas vetëpunësimit të tyre. Ndërsa 8 gra të riatdhesuara në vitin 2019 janë riaftësuar në rrobaqepësi dhe janë në fazën finale të negociimit për punësim në sektorin privat.

Në vijim në formë tabelore po paraqesim të dhënat e Divizionit lidhur me punësimin e të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin.

Të dhënat rreth punësimit nga Divizioni	
Të punësuar pas vuajtjes së dënimit	23 persona
Në procedurë të përfitimit të grantit	6 persona
Gra të riatdhesuara në vitin 2019 - të aftësuara në rrobaqepësi	8 persona
Aftësim profesional pas vetëpunësimit	3 persona
Persona të dënuar që kanë kërkuar ndihmë për aftësim profesional, punësim, vetëpunësim	46

Nga të dhënat evidentohet se një numër prej 37 personave janë vetëpunësuar, aftësuar dhe trajnuar, mirëpo ndihmë kanë kërkuar 46 persona në tërësi dhe nuk janë ofruar të dhëna se pse pjesës tjetër të kërkuesve nuk u është ofruar ndihma.

Vështirësia për t'u kyçur në Tregun e Punës

Të dhënat nga Divizioni evidentojnë bashkëpunim ‘të shkëlqyer’, me institucionet tjera, ndërsa evidentohet vështirësia e punësimit të personave të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin për shkak të kaluarës së tyre kriminale.

Nga përgjigjet e Divizionit konstatohet në veçanti vështirësia e punësimit në ato pozita ku kërkohet certifikata e të kaluarës kriminale (në sektorin publik kërkohet), ndërsa si raste pozitive përmenden disa biznese që kanë ofruar bashkëpunim dhe janë vetë-ofruar për punësimin e tyre.

Çështje shumë e rëndësishme nga të dhënat e Divizionit rezulton të jetë mungesa e buxhetit për trajtimin e këtyre rasteve dhe përmbushjes së përgjegjësisë.

Evidentohet se deri më tani nevojat financiare janë mbuluar nga programi R&R që zbatohet dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Përpos çështjes së mungesës së një buxheti të posaçëm për nevojat e Divizionit në raport me të dënuarit për terrorizëm dhe të rikthyerit, duhet të trajtohen edhe rastet e të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin dhe të rikthyerve të cilët nuk kanë kërkuar dhe pranuar aftësim profesional apo nuk kanë marrë pjesë në ndonjë nga programet e aftësimit/punësimit/vetëpunësimit.

Duke qenë se Divizioni vepron vetëm në baza vullnetare – sipas kërkesave të subjekteve duhet pasur parasysh se në mesin e të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin, mund të ketë raste që nuk njohin asnjë nga institucionet e Kosovës, nuk kërkojnë asnjë lloje ndihme, dhe në këtë formë mund të bëhen pre e financuesve dhe rekrutuesve për kryerjen e veprave terroriste.

Në këtë formë përpos që nuk arrihet qëllimi i dënimit, nuk kemi risocializim dhe ri-integrimit të të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin, rrezikohet edhe përsëritja e veprave penale nga kryerësit e njëjtë.

ROLI I AGJENCISË SË PUNËSIMIT DHE QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE PËR RI INTEGRIMIN E TË RIKTHYERVE

Agjencia Qendrore e Punësimit dhe zyret e saj nëpër komuna dhe Qendrat për Punë Sociale që veprojnë në kuadër të drejtorive të shëndetësisë nëpër komuna, kanë rolin e tyre plotësues në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të personave të dënuar për vepra që ndërlidhen me terrorizmin dhe familjarët e tyre.

BIRN ka kërkuar të dhëna nga Agjencia e Punësimit dhe Qendrat për Punë Sociale lidhur me trajtimin e rasteve, këshillimin, aftësimin, punësimin dhe vetëpunësimin e të dënuarve për terrorizëm, por rezultoi disa nga qendra për punë sociale abstenojnë nga përgjegjësia e tyre për t'i këshilluar këto raste ashtu edhe siç e kanë përgjegjësi.

Po ashtu, në Agjencinë e Punësimit rezultoi se nuk ka asnjë evidencë lidhur me personat e dënuar për vepra penale që lidhen me terrorizmin dhe të cilëve u jepen shërbime.

Kjo sepse sipas të dhënave që ka pranuar BIRN nga Agjencia e Punësimit¹⁵, 'Ne si Agjenci e Punësimit nuk posedojmë evidencë lidhur me personat që kanë të bëjnë me terrorizëm. Në Agjencinë e Punësimit tek shërbimet e punësimit nuk ofrojmë shërbime për këtë kategori”.

Kjo situatë është e dëmshme në të paktën dy drejtime – fillimisht, personave të përfshirë në vepra që lidhen me terrorizëm nuk u jepen shërbimet adekuate, sepse ata nuk evidentohen si të tillë, nuk evidentohet kompleksiteti i çështjeve të tyre, nuk evidentohet vështirësia e punësimit të tyre, nuk adresohen nevojat e tyre dhe në këtë formë jo vetëm që rrezikohet procesi i aftësimit dhe punësimit apo vetëpunësimit të tyre, mirëpo rrezikohet edhe procesi i rehabilitimit, risocializimit dhe ri-integrimit të tyre për shkak të pamundësisë për të pasur një mirëqenie që derivon nga punësimi i tyre.

Në anën tjetër, dëmi tjetër shkaktohet nga mungesa e komunikimit dhe pamundësimi i qasjes ndërsektoriale ndaj këtyre rasteve sepse personat e aftësuar përmes programeve të ShKK-së apo ShSK-së, nuk e kanë vazhdimësinë e tyre edhe në Agjencinë e Punësimit dhe kështu ndërpritet një hallkë që do të ishte shume e dobishme për zhvillimin profesional të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin dhe rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre.

¹⁵Përgjigja e Drin Haraçia - Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Kosovës, përgjigje përmes e-mailit për BIRN, datë 6 dhjetor 2021

Në këtë drejtim, përkundër që Agjencia e Punësimit dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës kanë bashkëpunim në drejtim të cilësisë së trajnimeve, testimit dhe certifikimit të të dënuarve – nuk ka një evidencim specifik për të dënuarit për vepra që lidhen me terrorizmin, e kompleksiteti i këtyre rasteve dallon esencialisht në raport me rastet e natyrave tjera.

Si rast shembull, është rasti i Zyrës së Punësimit në Gjakovë, ku rezulton se tek ta është referuar një rast nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, i cili rast pas aftësimit është punësuar, mirëpo pasur parasysh se Agjencia e Punësimit në Qendër nuk ka një evidencë specifike për këto raste, rasti i Gjakovës është përjashtim.

Zyra e Punësimit në Komunën e Gjilanit deklaroi për BIRN se nuk kanë ndonjë rast të përfshirë në vepra që lidhen me terrorizëm sepse ‘palët nuk deklarojnë krejt për veten’, duke evidentuar kështu mungesën e një bashkëpunimi me institucionet tjera relevante me qëllim të evidentimit dhe aftësimit të subjekteve të përfshirë në vepra që lidhen me terrorizmin me qëllim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre përmes aftësimit profesional të tyre.

Komuna e Drenasit në përgjigjet e tyre për BIRN deklaroi se nuk kanë pasur asnjë rast që kanë këshilluar apo aftësuar për punësim të dënuar për vepra që lidhet me terrorizmin.

Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë edhe pse nga një zonë nga ku ka pasur dhjetëra qytetarë që janë përfshirë në vepra që lidhen me terrorizmin, deklaroi për BIRN se nuk kanë pasur asnjë rast të cilit i kanë ofruar këshillim.

Kjo e dëshmon se Qendrat për Punë Sociale janë anashkaluar në ofrimin e rolit të tyre profesional.

Ndryshe nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë¹⁶, në Prishtinë kjo qendër ka identifikuar 12 të rritur dhe 28 fëmijë të përfshirë në raste që ndërlidhen me terrorizmin dhe të gjitha këto raste sipas të dhënave nga QPS në Prishtinë janë në skemën e asistencës sociale.

Po ashtu QPS në Prishtinë¹⁷ deklaroi se punëtorët social përveç këshillimit social e psikologjik, lidhur me punësimin dhe aftësimin, rastet i orientojnë në Zyrën e Punësimit, mirëpo nuk kanë ndonjë informacion të mëtejshëm rreth punësimit eventual të tyre.

Kjo evidenton një mungesë të komunikimit në mes të QPS-së dhe Zyrës së Punësimit e cila mund të rezulton me dëmtim të buxhetit pasi që ndonjë nga subjektet mund të punësohet dhe Qendra për Punë Sociale nuk e ka informacionin e kthyer rreth rastit që e ka orientuar tek Zyra e Punësimit.

Komuna tjera që nuk janë evidentuar në këtë pjesë dhe të cilave u janë dërguar pyetje, siç evidentohet në analizë nuk kanë kthyer përgjigje në pyetjet e dërguara nga BIRN.

Të dhënat e pasqyruara nga Zyra e Punësimit dhe Zyrat rajonale të punësimit dhe qendrat për punë sociale evidentojnë një mungesë të koordinimit në mes të Agjencisë së Punësimit dhe institucioneve tjera relevante me qëllim të evidentimit, aftësimit, punësimit dhe vetëpunësimit të rasteve të personave të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin.

¹⁶Gani Mustaga - Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë në Jugut, përgjigje përmes e-mailit për BIRN datë 6 dhjetor 2021

¹⁷Vehbi Mujku - Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, përgjigjet përmes e-mailit për BIRN datë 6 dhjetor 2021

Po ashtu, të dhënat e kthyer nga qendrat për punë sociale, me disa përjashtime, tregojnë se mundon bashkëpunimi i duhur me institucionet tjera, Zyrat e Punësimit, ShKK-në dhe ShSK-në e po ashtu në disa raste qendrat për punë sociale nuk janë përfshirë fare në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit përmes ofrimit të shërbimeve të këshillimit psiko-social.

Jashtë procesit

Të dhënat tregojnë që përpos problemeve të sipërpërmendura në Kosovë janë edhe disa kategori të cilat kanë mbetur jashtë procesit të risocializimit dhe ri-integrimit.

Familjet e të vrarëve në zonat e luftës nuk janë të përfshira në asnjë program i cili synon që të shmangen shkaktarët ekonomik të radikalizimit të familjeve të tyre.

Fëmijët janë po ashtu pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Fëmijët e rikthyer në mënyrë të organizuar nga zonat e luftës më 2019 dhe 2021 kanë qenë pjesë e disa programeve të MPB-së, ku është synuar ri-integrimi dhe risocializimi i tyre, mirëpo nga procesi janë përjashtuar fëmijët prindërit e të cilëve janë vrarë në Siri dhe Irak, apo prindërit e të cilëve janë kthyer para vitit 2019-të jashtë procesit të organizuar të kthimit.

REKOMANDIME;

- Institucionet e Kosovës duhet të grumbullojnë të dhëna periodike për nivelin e punësimit të personave të dënuar apo që kanë shfaqur prirje radikale.
- Kategori të caktuara, si fëmijët dhe familjet duhet të përfshihen në programe konkrete rehabilitimi.
- Draft Strategjia duhet të përfshijë aktivitete të qarta, konkrete dhe të renditura taksativisht dhe të parashoh forma të sigurta dhe afatgjate të financimit me qëllim të mbështetjes së aftësimit profesional, punësimit dhe vetëpunësimit të rikthyerve dhe të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin;
- Draft Strategjia duhet të pasqyrojë dhe përfshijë më gjerësisht rolin dhe përgjegjësitë e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues në trajtimin e rasteve të rikthyerve dhe të gjykuarve për vepra që lidhen me terrorizëm;
- Draft Strategjia duhet të përfshijë rolin e Agjencisë së Punësimit në aftësimin profesional të dënuarve për terrorizëm;
- Të krijohet një data bazë e centralizuar dhe e përbashkët e Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues, Agjencisë së Punësimit dhe udhëhequr nga Divizioni ku përfshihen të dhënat lidhur me trajnimet, shkollimin, aftësimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin e të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin;
- Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit dhe Shërbimin e Sprovues duhet të inkurajojnë dhe mundësojnë që të gjithë të dënuarit për vepra që lidhen me terrorizmin të aftësohen dhe të certifikohen gjatë vuajtjes së dënimit apo periudhës së sprovës;
- Shërbimi Sprovues i Kosovës duhet të ketë programe të veçantë të aftësimit, punësimit dhe vetëpunësimit për të dënuarit për terrorizëm por edhe të hartojë programe individuale për këta persona;
- Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues dhe Divizionit duhet t'u alokohet buxhet i veçantë me qëllim të realizimit të përgjegjësiave të tyre kundrejt personave të dënuar për vepra penale që lidhen me terrorizmin;
- Duhet të rritet stafi i Shërbimit Sprovues të Kosovës përgjegjës për rastet e të dënuarve për vepra që lidhen me terrorizmin;
- Duhet trajnime shtesë dhe të veçanta për stafin e ShSK-së në raport me personat e dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin;
- Divizioni në bashkërendim me Agjencinë e Punësimit duhet të inkurajojnë bizneset private për punësimin e të dënuarve për terrorizëm në fushat të cilat ata janë aftësuar;
- Divizioni në bashkërendim me ShKK-në, ShSK-në, Agjencinë e Punësimit dhe Qendrat për Punë Sociale duhet t'i ofrojnë mundësinë e aftësimit, punësimit, vetëpunësimit secilit nga të dënuarit për vepra që lidhen me terrorizmin;